

KËRKESË
Nr.1925, datë 18.4.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Mbështetur në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte) që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë-Plloç (loti I).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Për objektin shtëpi banimi për të cilin në kolonën përkatëse është bërë shënimi “i pakonfirmuar”, do të kërkohej konfirmim pranë ZVRPP-së Librazhd. Në bazë të informacionit që do të jepet nga kjo zyrë do të hartohet dhe lista që do të propozohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për objektin me shënimin “Proces legalizimi”, pronari përkatës do të likuidohet pas përfundimit të procesit të legalizimit dhe të regjistrimit pranë ZVRPP-së Librazhd, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 6 891 530.5 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë pikë pesë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi